



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021

**Lënda:** Kthim përgjigje.

**M C A**  
**Z. P.TH**

I nderuar z. {...}!

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj, regjistruar me numër rendor 21, datë 12.05.2021, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2148 Prot., datë 12.05.2021, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Neni 65 i Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon: “1. *Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.*

Dorëheqja është një akt vullnetar që bazohet në vullnetin e lirë të magjistratit për të ndërprerë në çdo kohë ushtrimin e detyrës. Gjyqtari e shpreh këtë vullnet për t’i dhënë fund ushtrimit të detyrës duke iu drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke kërkuar prej tij deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes.

Dorëheqja është një nga rastet e parashikuara për mbarimin e statusit në nenin 64 të Ligjit për Statusin, i cili parashikon: 1. *Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjidhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën e pensionit; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.*

Referuar dispozitave të mësipërme, mbarimi i statusit të magjistratit vjen për shkak të ligjit, ndërsa vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka karakter deklarativ. Sipas nenit 65 të sipërcituar, dorëheqja krijon efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Në çdo rast, mbarimi i statusit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë para mbarimit të statusit për shkak të ligjit. Në këtë rast, vendimi i Këshillit ka karakter deklarativ, që do të thotë se është një vendim i cili nuk ndryshon apo krijon një të drejtë apo marrëdhënie të re juridike, por vetëm vërteton qenien apo mosqenien e një marrëdhënieje të caktuar, e cila ekziston pavarësisht nga vendimi, në rastin konkret, vërteton dhënien fund ushtrimit të detyrës së gjyqtarit, sipas vullnetit të shprehur.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në Nenin 147/a: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit; ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre; d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; ë) **ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.**”

Ndërsa ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon në Nenin 86: “Në zbatim të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për çështjet e mëposhtme në lidhje me të gjithë gjyqtarët, përveç gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese: a) emërimin; b) caktimin në pozicion; c) transferimin; ç) ngritjen në detyrë; d) komandimin dhe riemërimin; dh) vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale; e) vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin; ë) **çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj.**”

Siç mund të shihet, si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nuk parashikojnë në mënyrë shteruese funksionet dhe detyrat e Këshillit të Lartë Gjyqësor, por referojnë te ligji. Prandaj, pavarësisht formulimit të nenit 61, vendimmarrja e Këshillit të Lartë Gjyqësor bazohet në nenin 65 të Ligjit për Statusin, i cili në mënyrë të shprehur përcakton se **mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit.**

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

